

Indeksi i Transparencës Buxhetore të Komunave **2025**



Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	4	Deçan	15
Metodologjia	5	Ferizaj	16
Gjetjet kryesore për vitin 2025	6	Kaçanik	17
Analiza e performancës së komunave – indeksi i vitit 2025 krahasuar me indeksin e vitit 2024	9	Mitrovicë	18
Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor	11	Obiliq	19
Përfundime dhe rekomandime	13	Podujevë	20
Shtojca	14	Prizren	21
		Rahovec	22
		Shtime	23
		Vushtrri	24
		Hani i Elezit	25
		Gjilan	26
		Klinë	27
		Kamenicë	28
		Drenas	29
		Skënderaj	30
		Gjakovë	31
		Suharekë	32
		Istog	33
		Lipjan	34
		Dragash	35
		Prishtinë	36
		Viti	37
		Junik	38
		Graçanicë	39
		Malishevë	40
		Pejë	41
		Mitrovicë e Veriut	42
		Ranillug	43
		Fushë Kosovë	44
		Mamushë	45
		Novobërdë	46

Përmbledhje ekzekutive

Indeksi i Transparencës Buxhetore të Komunave për vitin 2025 tregon një përmirësim të përgjithshëm të nivelit të transparencës buxhetore në nivel lokal krahasuar me vitin paraprak. Vlerësimi i realizuar në këtë raport mat nivelin e publikimit të dokumenteve kryesore buxhetore dhe financiare, qasjen në informata mbi shpenzimin e parasë publike, si dhe përfshirjen e qytetarëve në proceset e planifikimit buxhetor gjatë vitit 2025. Rezultatet tregojnë se komunat kanë vazhduar të avancojnë në publikimin e informatave buxhetore, megjithatë nevojiten përmirësime të mëtejshme për të siguruar transparencë të plotë dhe të qëndrueshme.

Mesatarja e pikëve të Indeksit të Transparencës Buxhetore për vitin 2025 ka arritur në 64.5 pikë, krahasuar me 61 pikë në vitin 2024. Në vitin 2025, 10 komuna kanë arritur rezultatin maksimal prej 100 pikësh, numri më i lartë i komunave me vlerësim maksimal që nga fillimi i matjes së indeksit në vitin 2016. Gjithashtu, gjysma e komunave të Kosovës (19 nga 38) kanë arritur së paku 89.5 pikë, duke treguar një rritje të nivelit të transparencës në pjesën më të madhe të komunave. Në anën tjetër, gjashtë komuna si Klokoti, Leposaviqi, Parteshi, Shtërpca, Zubin Potoku dhe Zveçani nuk kanë arritur të grumbullojnë asnjë pikë, duke mbetur në fund të renditjes. Krahasuar me vitin paraprak, progresin më të madh e kanë shënuar komunat si Obiliqi (+60 pikë), Ferizaj (+52.5 pikë) dhe Gjilani (+43.5 pikë), ndërsa rënien më të madhe e kanë regjistruar komunat si Vitia (-35 pikë), Mitrovica e Veriut (-29 pikë) dhe Lipjani (-15 pikë).

Përmirësimi i transparencës buxhetore është reflektuar edhe në rritjen e numrit të dokumenteve të publikuara. Në vitin 2025, komunat kanë publikuar gjithsej 240 dokumente buxhetore dhe financiare dhe materiale të tjera mbështetëse. Përmirësim i dukshëm është shënuar edhe në publikimin e Kartelës Analitike të Kontos për shpenzimet buxhetore, nga 18 komuna në vitin 2024 në 20 komuna në vitin 2025. Gjatë procesit të hartimit të buxhetit për vitin 2026 janë organizuar 119 dëgjime buxhetore, ndërsa 28 nga 38 komunat kanë përmbushur kriterin e organizimit të së paku katër dëgjimeve buxhetore me qytetarë.

Sa i përket formatit të publikimit, shumica e dokumenteve buxhetore, përkatësisht 76%, janë publikuar në formate të hapura dhe lehtësisht të përdorshme, kryesisht në Excel dhe Word. Kjo është veçanërisht e dukshme te dokumentet e planifikimit buxhetor dhe raportimit financiar, ku pjesa më e madhe e dokumenteve janë publikuar në format që mundëson analizë dhe ripërdorim më të lehtë të të dhënave. Ndërsa 8% janë publikuar në format PDF dhe 16% si dokumente të skanuara, të cilat kufizojnë mundësinë për kërkim, analizë dhe ripërdorim të informacionit.

Një fushë që kërkon përmirësim të vazhdueshëm mbetet transparenca në kontratat publike dhe publikimi i informatave mbi përfituesit e subvencioneve. Sa i përket buxhetimit të përgjegjshëm gjinor, rezultatet tregojnë progres të kufizuar. Në vitin 2025, 19 nga 38 komunat kanë publikuar dokumente buxhetore gjinore, krahasuar me 17 komuna në vitin 2024.

Metodologjia

Indeksi i Transparencës Buxhetore është një raport më anë të të cilit Instituti GAP vlerëson transparencën buxhetore të komunave, duke përdorur metodologji të standardizuar për të gjitha komunat. Indeksi përditësohet që nga viti 2017 dhe synon të rrisë llogaridhënien dhe qasjen e qytetarëve në informacionet buxhetore në nivel lokal. Ky raport përfshin vlerësimin e publikimit të dokumenteve që komunat janë të detyruara t'i publikojnë sipas legjislacionit aktual, vlerësimin e publikimit të disa dokumenteve të tjera buxhetore që u ofrojnë qytetarëve më shumë informacion mbi përdorimin e fondeve publike, si dhe formatin e publikimit të tyre. Më saktësisht, ky raport vlerëson qasjen në dokumentet e planifikimit buxhetor për vitin 2026, raportet financiare të vitit 2025, të dhënat për përfituesit e subvencioneve, kontratat publike dhe informacionet mbi dëgjimet buxhetore.¹ Mbledhja e të dhënave për publikimin e dokumenteve është bërë duke kërkuar nga komunat të plotësojnë një pyetësor me vegëzat e dokumenteve të publikuara në uebfaqet e tyre zyrtare. Gjatë muajit maj 2026, Instituti GAP ka dërguar kërkesa te zyrat komunale për komunikim me publikun, ndërsa monitorimi i faqeve të komunave ka përfunduar në qershor 2026. Nga 38 komunat e Kosovës, 18 prej tyre janë përgjigjur pozitivisht, ndërsa 20 komuna nuk kanë dhënë përgjigje. Për komunat që nuk janë përgjigjur, vlerësimi është bërë në bazë të informatave të gjetura në uebfaqet e tyre, duke përjashtuar dokumentet që nuk janë gjetur me tri klikime në fushën e dedikuar për publikimin e raporteve të buxhetit.² Përditësimi i uebfaqeve të komunave ka ndihmuar në një funksionim dukshëm më të mirë të uebfaqeve krahasuar me vitet paraprake duke lehtësuar qasjen në dokumente dhe informata për qytetarët. Institucionet janë të obliguara të publikojnë çdo dokument publik të përfunduar, pavarësisht nëse qytetarët kanë bërë kërkesë për qasje ose jo. Sipas Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) për administratë të hapur në komuna³, komunat janë përgjegjëse për publikimin e raporteve financiare në uebfaqet e tyre përfshirë planin e buxhetit dhe planet investuese, raportet tremujore të shpenzimeve, Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB), raportin përmbledhës të buxhetit të komunës për vitin e kaluar fiskal, si dhe raportin e zyrës kombëtare të auditimit dhe rekomandimet. Ndërkaq lidhur me dëgjimet buxhetore, sipas të njëjtit udhëzim, komunat janë të obliguara të organizojnë të paktën nga një takim publik⁴ rreth KAB dhe projektbuxhetit meqë këto dokumente cilësohen si akte obligative për konsultime publike.⁵ Po ashtu, për projektbuxhetin e komunës, Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë obligon kuvendin komunal të mbajë dëgjime buxhetore me qytetarë.⁶ Në përgjithësi, UA për Administratë të Hapur në Komuna, ndonëse duke mos i kuantifikuar në numër, nxitë komunat që të mbajnë dëgjime buxhetore⁷ dhe takime tjera publike të numërta rreth investimeve të komunës, zhvillimit ekonomik lokal, dhe më shumë.⁸ Po ashtu, ndonëse jo e shpeshtë si praktikë, ka raste kur edhe qarkoret buxhetore i obligojnë komunat të mbajnë dëgjime buxhetore.⁹

1 Për më shumë informata rreth metodologjisë së llogaritjes të Indeksit, shihni platformën për Indeksin e Transparencës Buxhetore: <https://institutigap.org/transparenca-buxhetore/>

2 Nga 38 komunat e Republikës së Kosovës, deri më tani nuk kanë kthyer përgjigje në kërkesën tonë 16 prej tyre: Fushë Kosova, Gjakova, Graçanica, Juniku, Kllokoti, Malisheva, Mamusha, Novobërda, Obiliqi, Parteshi, Prishtina, Ranillugu, Shtërpca, Zubin Potoku, Zveçani dhe Leposaviqi.

3 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL). [Udhëzimi administrativ nr. 04/2023 për administratë të hapur në komuna](#). Neni 13.

4 Që në këtë rast ka kuptimin e dëgjimit buxhetor. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL). [Udhëzimi administrativ nr. 04/2023 për administratë të hapur në komuna](#). Neni 26.2

5 Po aty. [Neni 22.1.4](#) dhe [Neni 22.1.5](#)

6 [Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë](#). Neni 61.2

7 [Po aty](#). Neni 31

8 [Po aty](#). Neni 18.3

9 Sikurse në vitin 2016.


Gjetjet kryesore për vitin 2025

Transparenca buxhetore mundëson mbikëqyrje dhe llogaridhënie më të madhe në menaxhimin e financave publike, duke u dhënë qytetarëve mundësinë të informohen se si shpenzohen taksat e tyre dhe të kërkojnë përgjegjësi për përdorimin e tyre. Krahasuar me vitin paraprak, transparenca buxhetore në komuna është përmirësuar. Mesatarja e pikëve për vitin 2025 ka arritur në 64.5, nga 61 pikë sa ishte në vitin 2024. Të dhënat ndër vite tregojnë se gjithnjë e më shumë komuna po arrijnë nivel më të lartë të transparencës. Në vitin 2025, gjithsej 10 komuna kanë grumbulluar 100 pikë, duke arritur numrin më të madh të komunave me vlerësim maksimal që nga fillimi i matjes së indeksit. Po ashtu, gjysma e komunave (19 nga 38) kanë arritur të grumbullojnë të paktën 89.5 pikë, çka tregon se një pjesë e konsiderueshme e komunave kanë siguruar publikim relativisht të plotë të informatave dhe dokumenteve të përfshira në indeks.

Dhjetë komunat me vlerësim maksimal renditen në kuartilin e lartë. Nëntë komuna të tjera bëjnë pjesë në kuartilin e mesëm të lartë, me rezultate nga 87.25 deri në 99 pikë. Në kuartilin e mesëm të ulët renditen 10 komuna, me rezultate nga 35 deri në 87.1 pikë, ndërsa në kuartilin e ulët bëjnë pjesë nëntë komuna me deri në 35 pikë.

Nga komunat e renditura në kuartilin e ulët, tri kanë grumbulluar nga 12.5 deri në 27.5 pikë. Ndërkaq, Klllokoti, Leposaviqi, Parteshi, Shtërpca, Zubin Potoku dhe Zveçani nuk kanë grumbulluar asnjë pikë, duke mbetur në fund të renditjes për vitin 2025. Nga 38 komunat, 18 komuna iu janë përgjigjur kërkesave përmes postës elektronike,¹⁰ ndërsa 20 të tjera nuk kanë dhënë përgjigje në kërkesën zyrtare të dërguar.¹¹

Figura 1. Indeksi i transparencës buxhetore të komunave 2025



Klllokot/Leposaviq/Partesh/Shtërpca/Zubin Potok/Zveçan 0

Shenim: Në rastet kur dy ose më shumë komuna arrijnë të njëjtin numër pikësh, renditja mes tyre bëhet sipas rendit alfabetik të emrit të komunës.

Burimi: Instituti GAP

¹⁰ Deçan, Dragash, Drenas, Ferizaj, Istog, Kaçanik, Kamenicë, Lipjan, Mitrovicë e Jugut, Obiliq, Pejë, Podujevë, Prizren, Rahovec, Shtime, Skenderaj, Suharekë, Vushtrri.

¹¹ Fushë Kosovë, Gjakovë, Gjilan, Graçanicë, Hani i Elezit, Junik, Klinë, Klllokot, Leposaviq, Malishevë, Mamushë, Mitrovicë e Veriut, Novobërdë, Partesh, Prishtinë, Ranillug, Shtërpca, Viti, Zubin Potok, Zveçan.

Sipas rezultateve të indeksit për transparencën buxhetore për vitin 2025, komunat kanë publikuar gjithsej 240 dokumente buxhetore, përfshirë raporte financiare dhe dokumente mbështetëse të politikave buxhetore, si rregullorja për ndarjen e subvencioneve. Pjesëmarrja e qytetarëve në procesin buxhetor paraqet gjithashtu një nivel të rëndësishëm të angazhimit publik. Gjatë procesit të planifikimit të buxhetit për vitin 2026 janë evidentuar 119 dëgjime buxhetore. Nga 38 komuna, 28 kanë organizuar së paku katër dëgjime buxhetore me qytetarët, ndërsa një komunë ka mbajtur tri dëgjime, një komunë dy dëgjime dhe një komunë vetëm një dëgjim buxhetor.

Raportimi financiar dhe ekzekutimi i buxhetit është kategoria me numrin më të lartë të dokumenteve të publikuara, me gjithsej 133 dokumente. Dokumentet e planifikimit buxhetor përbëjnë kategorinë e dytë me numrin më të madh të publikimeve, me gjithsej 55 dokumente. Publikimi i Projektbuxhetit 2026 dhe Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026–2028 tregon për një qasje më të qëndrueshme të komunave në ofrimin e informacionit për procesin e planifikimit financiar.

Tek publikimi i kontratave të nënshkruara me operatorët ekonomikë ka hapësirë për më shumë përmirësim. Nga 38 komuna, 26 kanë publikuar kontratat në uebfaqet e tyre zyrtare, ndërsa 12 nuk kanë ofruar qasje në to. Kjo tregon nevojën për më shumë transparencë në lidhje me kontratat publike dhe shpenzimin e fondeve publike.

Tabela 1. Dokumentet e publikuara të indeksit për transparencë buxhetore komunale 2025 sipas formatit

Kategoria		Excel	PDF i			Gjithsej
			PDF	skanuar	Kërkesa	
Planifikimi Buxhetor	Buxheti i planifikuar për vitin 2026	21	3	1	0	25
	Korniza Afatmesme Buxhetore 2026–2028	19	5	6	0	30
	Gjithsej planifikimi buxhetor	40	8	7	0	55
Raportimi financiar dhe ekzekutimi i buxhetit	Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2025	19	1	0	0	20
	Raporti financiar TM1 për vitin 2025	24	3	2	0	29
	Raporti financiar TM2 për vitin 2025	23	3	3	0	29
	Raporti financiar TM3 për vitin 2025	22	3	2	0	27
	Raporti vjetor financiar për vitin 2025	22	4	2	0	28
	Gjithsej raportimi financiar	110	14	9	0	133
Subvencione	Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2025	16	2	4	0	22
	Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	9	3	0	18	30
	Gjithsej subvencione	25	5	4	18	52
Pjesëmarrja e qytetarëve	Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2026					119
Kontrata Publike	Kontratat e nënshkruara 2025	0	4	22	0	26


Burimi: Instituti GAP

Sa i përket formatit të publikimit, shumica e dokumenteve buxhetore, përkatësisht 76%, janë publikuar në formate të hapura dhe lehtësisht të përdorshme, kryesisht në Excel dhe Word. Kjo është veçanërisht e dukshme te dokumentet e planifikimit buxhetor dhe

raportimit financiar, ku pjesa më e madhe e dokumenteve janë publikuar në format që mundëson analizë dhe ripërdorim më të lehtë të të dhënave. Ndërsa 8% janë publikuar në format PDF dhe 16% si dokumente të skanuara, të cilat kufizojnë mundësinë për kërkim, analizë dhe ripërdorim të informacionit.

Në nivel të dokumenteve individuale, kartela analitike e shpenzimeve për vitin 2025 është publikuar në 95% të rasteve në format Excel, duke e bërë atë dokumentin më të qasshëm për analizë. Po ashtu, Projektbuxheti për vitin 2026 është publikuar në 84% të rasteve në Excel, ndërsa raporti financiar TM1 në 83% të rasteve. Në anën tjetër, rregullorja për ndarjen e subvencioneve është dokumenti që më së shpeshti (60% të rasteve) publikohet në format PDF të skanuar.

Figura 2. Dokumentet e publikuara nga komunat sipas formatit të publikimit (në përqindje)



Burimi: Instituti GAP

Gjatë vitit 2025, dokumentet më të publikuara nga komunat kanë qenë Korniza Afatmesme Buxhetore dhe Rregullorja për ndarjen e subvencioneve, të publikuara nga 30 komuna. Po ashtu, 29 komuna kanë publikuar raportet financiare për tremujorin e parë (TM1) dhe të dytë (TM2), ndërsa 28 komuna kanë publikuar Raportin Vjetor Financiar për vitin 2025. Në përputhje me kërkesat e Udhëzimit Administrativ të MAPL-së për administratë të hapur në komuna, publikimi i dokumenteve kryesore financiare paraqet një nivel të kënaqshëm të transparencës.

Kartela analitike e kontos për shpenzimet e buxhetit për vitin 2025 mbetet dokumenti me nivelin më të ulët të publikimit. Edhe pse ky dokument ka rëndësi të veçantë për llogaridhënien financiare dhe vlerësohet me pikët maksimale në indeks, ai vazhdon të publikohet nga një numër më i vogël i komunave.

Mirëpo, vërehet përmirësim i vazhdueshëm në publikimin e kartelës analitike, pasi numri i komunave që e kanë publikuar këtë dokument krahasuar me vitin paraprak është rritur nga 18 në 20.

Analiza e performancës së komunave – indeksi i vitit 2025 krahasuar me indeksin e vitit 2024

Rezultatet e performancës së komunave për vitin 2025, krahasuar me vitin 2024, tregojnë një përmirësim të përgjithshëm të nivelit të performancës komunale. Një numër i konsiderueshëm i komunave kanë shënuar rritje të pikëve dhe përmirësim të rangimit, duke reflektuar avancim në përmbushjen e kriterëve të vlerësimit dhe në zbatimin e praktikave më të mira të qeverisjes lokale.

Në vitin 2025, dhjetë komuna kanë arritur rezultatin maksimal prej 100 pikësh dhe janë renditur në vendin e parë. Krahas komunave që kanë ruajtur performancën maksimale nga viti paraprak, si Kaçaniku, Mitrovica e Jugut, Prizreni, Rahoveci, Shtimja dhe Vushtrria, përmirësim kanë shënuar Deçani, Ferizaj dhe Obiliqi, të cilat nga pozita dukshëm më të ulëta në vitin 2024 kanë kaluar në rangun më të lartë në vitin 2025. Veçanërisht Obiliqi, i cili nga 40 pikë në vitin 2024 ka arritur në 100 pikë në vitin 2025, si dhe Ferizaj nga 47.5 pikë është ngritur në rezultatin maksimal. Kjo për arsye të publikimit të të gjitha dokumenteve të indeksit dhe përmirësimit të formatit të publikimit.

Progres është evidentuar edhe te komunat që kanë kaluar nga rezultate mesatare në nivele të larta të performancës. Gjilani ka rritur rezultatin nga 53.5 pikë në 97 pikë, duke u pozicionuar në vendin e 11-të, ndërsa Gjakova ka rritje nga 52 pikë në 92.5 pikë. Ngjashëm, edhe Kamenica, Podujeva dhe Deçani, kanë avancuar ndjeshëm në rangim krahasuar me vitin paraprak.

Megjithatë, krahas përmirësimeve të përgjithshme, disa komuna kanë shënuar rënie të performancës krahasuar me vitin 2024. Rëniet më të theksuara janë te Vitia, e cila ka kaluar nga 90 pikë në 55 pikë, Mitrovica e Veriut nga 71 pikë në 42 pikë dhe Lipjani nga 100 pikë në 85 pikë. Gjithashtu, Klina, Skënderaj dhe Malisheva kanë shënuar ulje të rezultateve krahasuar me vitin paraprak. Në fund të renditjes vazhdojnë të jenë komunat me rezultate minimale ose pa pikë, përfshirë Killokotin, Leposaviqin, Parteshin, Shtërpcën, Zubin Potokun dhe Zveçanin.

Në përgjithësi, rezultatet e vitit 2025 tregojnë një trend pozitiv në performancën komunale, me rritje të numrit të komunave që arrijnë rezultate të larta dhe me përmirësim të ndjeshëm të disa komunave që më parë kishin performancë më të dobët. Megjithatë, dallimet ndërmjet komunave mbeten të konsiderueshme, prandaj nevojitet shkëmbim i praktikave të mira ndërmjet komunave me performancë të lartë dhe atyre që kanë nevojë për përmirësim.

Tabela 2. Renditja e komunave sipas pikëve për vitin 2025 (me renditje alfabetike për pikë të barabarta, krahasuar me vitin 2024)

Nr. rendor	Komuna	Pikët 2025	Pikët 2024	Rangimi 2025	Rangimi 2024
1	Deçan	100	75	1	18
2	Ferizaj	100	47.5	1	26
3	Kaçanik	100	100	1	1
4	Mitrovicë e Jugut	100	100	1	1
5	Obiliq	100	40	1	27
6	Podujevë	100	95	1	10
7	Prizren	100	100	1	1
8	Rahovec	100	100	1	1
9	Shtime	100	100	1	1
10	Vushtrri	100	100	1	1

11	Gjilan	97	53.5	11	24
12	Hani i Elezit	97	95	11	10
13	Drenas	95	95	13	10
14	Kamenicë	95	67.5	13	21
15	Klinë	95	100	13	1
16	Gjakovë	92.5	52	16	25
17	Skënderaj	92.5	100	16	1
18	Suharekë	90	85	18	14
19	Istog	89.5	85	19	14
20	Lipjan	85	100	20	1
21	Dragash	75	75.5	21	16
22	Prishtinë	72.5	75.5	22	16
23	Viti	55	90	23	13
24	Junik	53	70	24	20
25	Graçanicë	48	10	25	34
26	Malishevë	44	57.5	26	23
27	Mitrovicë e Veriut	42	71	27	19
28	Pejë	42	62.5	27	22
29	Ranillug	35	12.5	29	33
30	Fushë Kosovë	27.5	24.5	30	28
31	Mamushë	15	15	31	31
32	Novobërdë	12.5	17.5	32	30
33	Klllokot	0	5	33	36
34	Leposaviq	0	7.5	33	35
35	Partesh	0	20	33	29
36	Shtërpçë	0	15	33	31
37	Zubin Potok	0	0	33	37
38	Zveçan	0	0	33	37

Burimi: Instituti GAP

Trendi i publikimit të dokumenteve financiare dhe buxhetore gjatë viteve 2020-2025 tregon një prirje të përgjithshme pozitive, me rritje të numrit të komunave që kanë publikuar shumicën e dokumenteve kryesore financiare. Përmirësimi është evidentuar veçanërisht në raportet financiare tremujore, raportin vjetor financiar, kornizën afatmesme buxhetore, rregulloren për ndarjen e subvencioneve dhe kartelën analitike të kontos për shpenzimet buxhetore. Kjo tregon për forcim gradual të transparencës financiare dhe rritje të përkushtimit institucional për publikimin e informatave mbi menaxhimin e financave publike lokale.

Megjithatë, trendi nuk është i njëtrajtshëm në të gjitha fushat. Në vitin 2025 është vërejtur rënie në publikimin e buxhetit të planifikuar për vitin pasardhës, listave të përfituesve të subvencioneve dhe një ulje e lehtë e numrit të dëgjimeve buxhetore me qytetarë krahasuar me vitin 2024. Këto rezultate tregojnë se, përkundër progresit të përgjithshëm, komunat duhet të vazhdojnë përpjekjet për të siguruar transparencë më të plotë, veçanërisht në publikimin e dokumenteve që lidhen me planifikimin buxhetor dhe përfshirjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse.

Tabela 3. Numri i publikimit të dokumenteve dhe dëgjimeve buxhetore nga komunat

Dokumenti	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Raporti financiar TM 1 për vitin aktual	28	28	31	24	25	29
Raporti financiar TM 2 për vitin aktual	29	30	32	22	26	29
Raporti financiar TM 3 për vitin aktual	29	24	29	24	25	27
Raporti vjetor financiar për vitin e fundit	30	29	29	27	24	28
Buxheti i planifikuar për vitin pasardhës	34	28	31	23	27	25
Korniza Afatmesme Buxhetore	32	29	32	24	29	30
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	32	30	30	27	25	30
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin aktual	24	20	29	22	28	22
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin aktual	7	8	14	14	18	20
Dëgjime buxhetore me qytetarë për vitin pasardhës	84	106	130	91	123	119

Burimi: Instituti GAP

Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor

Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor (BPGJ) përfshin integrimin e një perspektive të qartë gjinore në kuadër të procesit buxhetor në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe përfshin zbatimin e analizës gjinore në formulimin, zbatimin dhe vlerësimin e buxheteve publike. Përfshirja e perspektivës gjinore në buxhetin komunal ndihmon në krijimin e politikave dhe programeve që pasqyrojnë nevojat dhe përvojat e ndryshme të grave dhe burrave, duke promovuar kështu barazinë gjinore dhe përmirësuar cilësinë e jetës për të gjithë qytetarët. Në Kosovë, barazia gjinore është e garantuar nga Kushtetuta, por në praktikë shoqëria mbetet diskriminuese ndaj grave, si në politikë, në tregun e punës, ashtu edhe në përfitimet nga fondet publike. Sipas Ligjit Nr. 05/L-020 për barazi gjinore, institucionet e Kosovës janë të detyruara të përfshijnë buxhetimin gjinor në të gjitha këto aspekte.¹²

Megjithëse buxhetimi i përgjegjshëm gjinor është i paraparë si obligim nga Ligji për barazi gjinore që nga viti 2015 dhe është kërkesë e Ministrisë së Financave përmes qarkoreve të buxhetit që nga viti 2018, deri më tani nuk është përfshirë si komponent i veçantë në vlerësimin me pikë të Indeksit të Transparencës Buxhetore.¹³ Kjo ka ndodhur për shkak se zbatimi i tij ka qenë relativisht i panjohur për komunat, ka munguar një standardizim i qartë në formatin dhe përmbajtjen e këtyre dokumenteve, dhe nuk ka pasur indikatorë të qartë për matjen e cilësisë së përmbajtjes së tyre. Prandaj, deri në këtë vit është trajtuar si një element vëzhgues dhe informues, por jo si pjesë e pikëzimit.

Sipas rezultateve të indeksit, në vitin 2025, nga gjithsej 38 komuna, vetëm 19 kanë publikuar dokumente të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor, duke shënuar një progres me dy komuna më shumë krahasuar me vitin paraprak. Në këtë kuadër, dokumentet e BPGJ zakonisht përfshijnë informacione buxhetore e financiare të ndara sipas gjinisë, si dhe informacion mbi integrimin e perspektivës gjinore në planifikimin dhe ndarjen e buxhetit. Përmirësim pozitiv në vitin 2025 kanë shënuar komunat si Deçani, Dragashi, Drenasi, Istogu, Kamenica, Peja, Podujeva, Prizreni, Rahoveci dhe Suhareka, të cilat nga mospublikimi në vitin 2024 kanë kaluar në publikimin e dokumenteve buxhetore gjinore. Në anën tjetër, disa komuna kanë shënuar rënie të performancës, pasi kanë publikuar dokumente buxhetore gjinore në vitin 2024, por nuk e kanë vazhduar këtë praktikë në vitin 2025. Këto komuna janë: Gjilani, Hani i Elezit, Klina, Mitrovica e Veriut, Prishtina dhe Viti.

Komunat si Gjakova, Ferizaj, Kaçaniku, Lipjani, Mitrovica e Jugut, Obiliqi, Shtimja, Skenderaj dhe Vushtrria kanë ruajtur performancën pozitive duke publikuar dokumentet buxhetore gjinore në të dy vitet.

¹² Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, [Ligji Nr. 05/L-020 për barazi gjinore](#), Neni 3. Pika 1.17

¹³ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, [Ligji Nr. 05/L-020 për barazi gjinore](#); Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. Qarkoret buxhetore 2019/01, 2018.

Në përgjithësi, viti 2025 paraqet një progres të moderuar në publikimin e dokumenteve buxhetore gjinore, por kërkon përpjekje të mëtejshme institucionale për të siguruar që kjo praktikë të jetë e qëndrueshme dhe të integrohet në kuadër të transparencës dhe llogaridhënies buxhetore në nivel lokal.

Tabela 4. (Mos)publikimi i dokumenteve për buxhetim të përgjegjshëm gjinor nga komunat

Nr.	Komuna	2023	2024	2025
1	Deçan	✗	✓	✓
2	Dragash	✓	✗	✓
3	Drenas	✗	✓	✓
4	Ferizaj	✓	✓	✓
5	Fushë Kosovë	✗	✗	✗
6	Gjakovë	✓	✓	✓
7	Gjilan	✓	✗	✗
8	Graçanicë	✗	✗	✗
9	Hani i Elezit	✗	✓	✗
10	Istog	✓	✗	✓
11	Junik	✓	✗	✗
12	Kaçanik	✓	✓	✓
13	Kamenicë	✓	✗	✓
14	Klinë	✗	✓	✗
15	Klllokot	✗	✗	✗
16	Leposaviq	✗	✗	✗
17	Lipjan	✓	✓	✓
18	Malishevë	Kërkesë	✗	✗
19	Mamushë	✗	✗	✗
20	Mitrovicë e Jugut	✓	✓	✓
21	Mitrovicë e Veriut	✗	✓	✗
22	Novobërdë	✗	✗	✗
23	Obiliq	✓	✓	✓
24	Partesh	✗	✗	✗
25	Pejë	✓	✗	✓
26	Podujevë	✓	✗	✓
27	Prishtinë	✓	✗	✗
28	Prizren	✓	✗	✓
29	Rahovec	✗	✗	✓
30	Ranillug	✗	✗	✗
31	Shtërpçë	✗	✗	✗
32	Shtime	✓	✓	✓
33	Skenderaj	✓	✓	✓
34	Suharekë	Kërkesë	✗	✓
35	Viti	✓	✗	✗
36	Vushtrri	✓	✓	✓
37	Zubin Potok	✗	✗	✗
38	Zveçan	✗	✗	✗

Burimi: Instituti GAP

Përfundime dhe rekomandime

Në vitin 2025, numri i komunave që kanë arritur pikët maksimale në Indeksin e Transparencës Buxhetore ka qenë më i larti që prej vitit 2017, kur ka filluar vlerësimi sistematik i transparencës buxhetore në nivel lokal. Ky rezultat pasqyron përkushtimin në rritje të një pjese të konsiderueshme të komunave për të përmbushur standardet e llogaridhënies publike dhe për të rritur qasjen e qytetarëve në informata financiare.

Përgjatë këtij viti është rritur numri i dokumenteve buxhetore të publikuara në faqet zyrtare të komunave. Po ashtu, është shënuar një përmirësim i mesatares së pikëve në indeks, e cila arriti në 64.5 pikë krahasuar me 61 pikë në vitin 2024, duke reflektuar një trend pozitiv në nivel të përgjithshëm.

Vlen të theksohet se disa nga komunat me përmirësimin më të madh të këtij viti ishin ndër komunat me regres më të theksuar një vit më parë, ndërsa e kundërta vlen për disa prej komunave që tani kanë rënë në rangim, një tregues se performanca e arritur në transparencë buxhetore ende nuk është plotësisht e konsoliduar dhe mund të luhatet ndjeshëm nga një vit në tjetrin.

Këto rezultate nënvizojnë se, ndonëse trendi i përgjithshëm është pozitiv, ekziston ende hapësirë e konsiderueshme për përmirësim të performancës në shumicën e komunave, veçanërisht sa i përket transparencës në kontratat publike, dhe publikimit të dokumenteve të Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinator. Në këtë drejtim, është e nevojshme që komunat të ndërmarrin hapa konkretë për të garantuar një transparencë më të lartë dhe më të qëndrueshme.

Për të përmirësuar transparencën buxhetore, Instituti GAP rekomandon që:

- Të rishikohet baza ligjore ashtu që institucionet publike, në këtë rast komunat, të obligohen që dokumentet buxhetore t'i publikojnë në formate lehtë të përdorshme, sikurse 'Excel' apo 'Word', meqë edhe në vitin 2025 rreth një e dhjeta e dokumenteve buxhetore vazhdojnë të publikohen si PDF të skanuara. Publikimi në PDF të skanuar kufizon kërkimin, analizën dhe ripërdorimin e të dhënave.
- Komunat të sigurohen që të kenë kapacitete adekuate njerëzore dhe teknike për publikimin e rregullt të dokumenteve buxhetore, gjithmonë në seksione të njëjta dhe të lehta për navigim në uebfaqet zyrtare. Gjetjet e vlerësimit për vitin 2025 tregojnë raste të shumta kur komunat bien ndjeshëm në rangim nga viti në vit, disa prej tyre në mënyrë të përsëritur, ndonëse me shumë gjasë i kanë finalizuar dokumentet buxhetore, por nuk i publikojnë ato në mënyrë të rregullt.
- Megjithëse fryma e bazës ligjore aktuale inkurajon komunat të organizojnë dëgjime buxhetore, dhe ndonëse shumica prej tyre tashmë e bëjnë këtë në praktikë, dispozitat ligjore duhet të jenë më të qarta dhe më të detajuara. Ato duhet të rrisin nivelin minimal të kërkuar dhe të përcaktojnë një numër të detyrueshëm e përfaqësues dëgjimesh publike që komunat janë të obliguara të mbajnë lidhur me Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) dhe projektbuxhetin, me qëllim të sigurimit të një pjesëmarrjeje të qytetarëve në këto procese të rëndësishme.
- Të gjitha komunat duhet të publikojnë në mënyrë të plotë, të qartë dhe të përditësuar listat e përfituesve të subvencioneve, përfshirë shumën e përfituar dhe qëllimin e mbështetjes, në mënyrë që të rritet transparenca në ndarjen e fondeve publike.
- Të gjitha komunat duhet t'i publikojnë rregullisht kontratat e nënshkruara me operatorët ekonomikë, për të rritur llogaridhënien mbi shpenzimin e parasë publike.
- Meqë dokumenti Kartela Analitike e Kontos mbetet ndër më pak të publikuarat, komunat duhet ta trajtojnë publikimin e saj si prioritet, pasi ofron informacion të rëndësishëm për monitorimin e detajuar të shpenzimeve buxhetore.
- Komunat t'i kushtojnë rëndësi publikimit të dokumenteve lidhur me Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinator, marrë parasysh rëndësinë që ka përdorimi i tyre në ndërtimin e politikave nga komuna, dhe të pasurojnë përmbajtjen e tyre përtej obligimeve bazike të kërkuara sipas qarkoreve buxhetore.

Shtojca

Vlerësimi i detajuar për secilën komunë sipas rangimit dhe renditjes alfabetike.

Deçan	15
Ferizaj	16
Kaçanik	17
Mitrovicë	18
Obiliq	19
Podujevë	20
Prizren	21
Rahovec	22
Shtime	23
Vushtrri	24
Hani i Elezit	25
Gjilan	26
Klinë	27
Kamenicë	28
Drenas	29
Skënderaj	30
Gjakovë	31
Suharekë	32
Istog	33
Lipjan	34
Dragash	35
Prishtinë	36
Viti	37
Junik	38
Graçanicë	39
Malishevë	40
Pejë	41
Mitrovicë e Veriut	42
Ranillug	43
Fushë Kosovë	44
Mamushë	45
Novobërdë	46

Deçan

1/38

Komuna e Deçanit ka arritur rezultatin maksimal prej 100 pikësh në Indeksin e Transparencës Buxhetore 2025, duke u renditur në kuartilin e lartë të komunave me performancën më të mirë. Ky rezultat është arritur si rezultat i publikimit të të gjitha dokumenteve të përfshira në indeks, duke përfshirë dokumentet e planifikimit buxhetor, raportimit financiar, subvencioneve, kontratave publike dhe pjesëmarrjes qytetare.

Shumica e dokumenteve janë publikuar në format Excel, ndërsa kontratat e nënshkruara janë publikuar në format PDF të skanuar. Komuna gjithashtu i është përgjigjur kërkesës sonë për qasje në dokumente zyrtare dhe ka organizuar së paku katër dëgjime buxhetore me qytetarët.

Dokumenti	Excel	PDF	PDF i skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2025	5			
Raporti financiar TM 2 për vitin 2025	5			
Raporti financiar TM 3 për vitin 2025	5			
Raporti vjetor financiar për vitin 2025	15			
Buxheti i planifikuar për vitin 2026	5			
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	5			
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2025	10			
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2025	20			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2026	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2026	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2026	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2026	2.5			
Korniza Afatmesme Buxhetore 2026–2028	10			
Kontratat e nënshkruara 2025			10	
Total				

Indeksi:
100

Ferizaj

1/38

Komuna e Ferizajt ka arritur rezultatin maksimal prej 100 pikësh në Indeksin e Transparencës Buxhetore 2025, duke u renditur në kuartilin e lartë të komunave me performancën më të mirë. Ky rezultat është arritur si rezultat i publikimit të të gjitha dokumenteve të përfshira në indeks, duke përfshirë dokumentet e planifikimit buxhetor, raportimit financiar, subvencioneve, kontratave publike dhe pjesëmarrjes qytetare.

Shumica e dokumenteve janë publikuar në format Excel, ndërsa kontratat e nënshkruara janë publikuar në format PDF të skanuar. Komuna gjithashtu i është përgjigjur kërkesës sonë për qasje në dokumente zyrtare dhe ka organizuar së paku katër dëgjime buxhetore me qytetarët.

Dokumenti	Excel	PDF	PDF i skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2025	5			
Raporti financiar TM 2 për vitin 2025	5			
Raporti financiar TM 3 për vitin 2025	5			
Raporti vjetor financiar për vitin 2025	15			
Buxheti i planifikuar për vitin 2026	5			
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	5			
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2025	10			
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2025	20			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2026	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2026	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2026	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2026	2.5			
Korniza Afatmesme Buxhetore 2026–2028	10			
Kontratave të nënshkruara 2025			10	
Total				

Indeksi:
100

Kaçanik

1/38

Komuna e Kaçanikut ka arritur rezultatin maksimal prej 100 pikësh në Indeksin e Transparencës Buxhetore 2025, duke u renditur në kuartilin e lartë të komunave me performancën më të mirë. Ky rezultat është arritur si rezultat i publikimit të të gjitha dokumenteve të përfshira në indeks, duke përfshirë dokumentet e planifikimit buxhetor, raportimit financiar, subvencioneve, kontratave publike dhe pjesëmarrjes qytetare.

Shumica e dokumenteve janë publikuar në format Excel, ndërsa kontratat e nënshkruara janë publikuar në format PDF të skanuar. Komuna gjithashtu i është përgjigjur kërkesës sonë për qasje në dokumente zyrtare dhe ka organizuar së paku katër dëgjime buxhetore me qytetarët.

Dokumenti	Excel	PDF	PDF i skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2025	5			
Raporti financiar TM 2 për vitin 2025	5			
Raporti financiar TM 3 për vitin 2025	5			
Raporti vjetor financiar për vitin 2025	15			
Buxheti i planifikuar për vitin 2026	5			
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	5			
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2025	10			
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2025	20			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2026	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2026	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2026	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2026	2.5			
Korniza Afatmesme Buxhetore 2026–2028	10			
Kontratat e nënshkruara 2025			10	
Total				

Indeksi:
100

Mitrovicë

1/38

Komuna e Mitrovicës ka arritur rezultatin maksimal prej 100 pikësh në Indeksin e Transparencës Buxhetore 2025, duke u renditur në kuartilin e lartë të komunave me performancën më të mirë. Ky rezultat është arritur si rezultat i publikimit të të gjitha dokumenteve të përfshira në indeks, duke përfshirë dokumentet e planifikimit buxhetor, raportimit financiar, subvencioneve, kontratave publike dhe pjesëmarrjes qytetare.

Shumica e dokumenteve janë publikuar në format Excel, ndërsa kontratat e nënshkruara dhe rregullorja për subvencione janë publikuar në format PDF të skanuar. Komuna gjithashtu i është përgjigjur kërkesës sonë për qasje në dokumente zyrtare dhe ka organizuar së paku katër dëgjime buxhetore me qytetarët.

Dokumenti	Excel	PDF	PDF i skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2025	5			
Raporti financiar TM 2 për vitin 2025	5			
Raporti financiar TM 3 për vitin 2025	5			
Raporti vjetor financiar për vitin 2025	15			
Buxheti i planifikuar për vitin 2026	5			
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve			5	
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2025	10			
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2025	20			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2026	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2026	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2026	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2026	2.5			
Korniza Afatmesme Buxhetore 2026–2028	10			
Kontratat e nënshkruara 2025			10	
Total				

Indeksi:
100

Obiliq

1/38

Komuna e Obiliqit ka arritur rezultatin maksimal prej 100 pikësh në Indeksin e Transparencës Buxhetore 2025, duke u renditur në kuartilin e lartë të komunave me performancën më të mirë. Ky rezultat është arritur si rezultat i publikimit të të gjitha dokumenteve të përfshira në indeks, duke përfshirë dokumentet e planifikimit buxhetor, raportimit financiar, subvencioneve, kontratave publike dhe pjesëmarrjes qytetare.

Shumica e dokumenteve janë publikuar në format Excel, ndërsa kontratat e nënshkruara dhe rregullorja për subvencione janë publikuar në format PDF të skanuar. Komuna gjithashtu i është përgjigjur kërkesës sonë për qasje në dokumente zyrtare dhe ka organizuar së paku katër dëgjime buxhetore me qytetarët.

Dokumenti	Excel	PDF	PDF i skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2025	5			
Raporti financiar TM 2 për vitin 2025	5			
Raporti financiar TM 3 për vitin 2025	5			
Raporti vjetor financiar për vitin 2025	15			
Buxheti i planifikuar për vitin 2026	5			
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve			5	
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2025	10			
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2025	20			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2026	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2026	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2026	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2026	2.5			
Korniza Afatmesme Buxhetore 2026–2028	10			
Kontratrat e nënshkruara 2025			10	
Total				

Indeksi:
100

Podujevë

1/38

Komuna e Podujevës ka arritur rezultatin maksimal prej 100 pikësh në Indeksin e Transparencës Buxhetore 2025, duke u renditur në kuartilin e lartë të komunave me performancën më të mirë. Ky rezultat është arritur si rezultat i publikimit të të gjitha dokumenteve të përfshira në indeks, duke përfshirë dokumentet e planifikimit buxhetor, raportimit financiar, subvencioneve, kontratave publike dhe pjesëmarrjes qytetare.

Shumica e dokumenteve janë publikuar në format Excel, ndërsa kontratat e nënshkruara dhe rregullorja për subvencione janë publikuar në format PDF të skanuar. Komuna gjithashtu i është përgjigjur kërkesës sonë për qasje në dokumente zyrtare dhe ka organizuar së paku katër dëgjime buxhetore me qytetarët.

Dokumenti	Excel	PDF	PDF i skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2025	5			
Raporti financiar TM 2 për vitin 2025	5			
Raporti financiar TM 3 për vitin 2025	5			
Raporti vjetor financiar për vitin 2025	15			
Buxheti i planifikuar për vitin 2026	5			
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve				
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2025	10			
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2025	20			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2026	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2026	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2026	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2026	2.5			
Korniza Afatmesme Buxhetore 2026–2028	10			
Kontratat e nënshkruara 2025			10	
Total				

Indeksi:
100

Prizren

1/38

Komuna e Prizrenit ka arritur rezultatin maksimal prej 100 pikësh në Indeksin e Transparencës Buxhetore 2025, duke u renditur në kuartilin e lartë të komunave me performancën më të mirë. Ky rezultat është arritur si rezultat i publikimit të të gjitha dokumenteve të përfshira në indeks, duke përfshirë dokumentet e planifikimit buxhetor, raportimit financiar, subvencioneve, kontratave publike dhe pjesëmarrjes qytetare.

Shumica e dokumenteve janë publikuar në format Excel, ndërsa kontratat e nënshkruara dhe rregullorja për subvencione janë publikuar në format PDF. Komuna gjithashtu i është përgjigjur kërkesës sonë për qasje në dokumente zyrtare dhe ka organizuar së paku katër dëgjime buxhetore me qytetarët.

Dokumenti	Excel	PDF	PDF i skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2025	5			
Raporti financiar TM 2 për vitin 2025	5			
Raporti financiar TM 3 për vitin 2025	5			
Raporti vjetor financiar për vitin 2025	15			
Buxheti i planifikuar për vitin 2026	5			
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	5			
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2025	10			
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2025	20			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2026	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2026	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2026	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2026	2.5			
Korniza Afatmesme Buxhetore 2026–2028	10			
Kontratat e nënshkruara 2025		10		
Total				

Indeksi:
100

Rahovec

1/38

Komuna e Rahovecit ka arritur rezultatin maksimal prej 100 pikësh në Indeksin e Transparencës Buxhetore 2025, duke u renditur në kuartilin e lartë të komunave me performancën më të mirë. Ky rezultat është arritur si rezultat i publikimit të të gjitha dokumenteve të përfshira në indeks, duke përfshirë dokumentet e planifikimit buxhetor, raportimit financiar, subvencioneve, kontratave publike dhe pjesëmarrjes qytetare.

Shumica e dokumenteve janë publikuar në format Excel, ndërsa kontratat e nënshkruara janë publikuar në format PDF të skanuar. Komuna gjithashtu i është përgjigjur kërkesës sonë për qasje në dokumente zyrtare dhe ka organizuar së paku katër dëgjime buxhetore me qytetarët.

Dokumenti	Excel	PDF	PDF i skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2025	5			
